



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:278627  
Datë: 09.02.2024  
Numri i dokumentit: 05305934

**AA.nr.302/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Xh.R, nga fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovë, kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1682/2019 të datës 22.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit Xh.R, nga fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1682/2019 i datës 22.12.2022, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1682/2019 të datës 22.12.2022, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.R, nga fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me nr.147/19 të datës 12.06.2019.

Kundër aktgjykimit të lartcekur në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktgjykimi ankimuar të priset e lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje duke u bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore, respektivisht neni 201 të LPK-së.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

## **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatë me datën 16.07.2019, kundër vendimit të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me nr.147/19 të datës 12.06.2019, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit Xh.R me nr.362/DL e datës 27.05.2019 si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi vendimi i KRU "Prishtina", nr.181437/17 i datës 25.10.2017.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lartcekur të Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit i referohet Rregullores nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë e cila në nenin 36 par. 3 përcakton se "të gjithë konsumatorët, të cilët aktualisht nuk kanë ujëmatës dhe faturohen pa ujëmatës janë të obliguar që në bashkëpunim dhe në bazë të udhëzimeve të Ofruesit të shërbimeve të instalojnë ujëmatësin në afat: 3.1. Prej gjashtë (6) muajve prej datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore për konsumatorët komercial dhe institucional; dhe 3.2. Prej një (1) viti prej datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore për konsumatorët shtëpiak 4. Pas skadimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij Neni, Ofruesi i shërbimeve do të ndërpres ofrimin e shërbimeve për konsumatorët të cilët nuk kanë vepruar në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni". Me provat e administruara ne seancën e shqyrtimit kryesor, përkatësisht vendimi i datës 25.10.2017, të lëshuar nga KRU "Prishtina", gjykata e shkallës së parë vëren se, deri më dt. 01.09.2011 paditësi, ka qenë pa ujëmatës individual dhe faturimi i është bërë paushall. Vendimi i referohet procesit të inspektimit nr. 26/16 dt. 20.10.2017 ku është konstatuar se në muajin 08/2011 është bërë faturimi pa ujëmatës dhe nga dt.01.09.2011 e deri tani faturimi bëhet me ujëmatës (nr. serik 3695112). Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë vlerëson se, e paditura drejtë ka vendosur kur ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka vërtetuar vendimin dt. 25.10.2017.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se në vendimin e KRU "Prishtina" nr. 181437/17 dt. 25.10.2017, ka parashtruar ankesë në KKK Rajoni Prishtinës, dhe ka kontestuar borxhin e faturuar para datës 09.2011 me arsyetim se gjatë kësaj periudhe në fshatin Miradi e Epërme nuk ka pas furnizim të rregullt me ujë nga ujësjellësi, dhe faturimi paushall për këtë periudhë kohore ka qenë shume i lartë në

krahasim me shpenzimet e ujit, pasi që nuk ka pasur fare dhe se kjo është vërtetuar edhe nga pasqyra e hargjimeve të ujit të faturuar pas vendosjes së ujëmatësit individual. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, kjo për faktin se konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Pra, gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave dhe atë: Vendim kontestues i dt.21.06.2019, formulari i ankesës dt.12.10.2017, kërkesa për korrigjimin e faturës drejtuar në Kompaninë Rajonale nga pala paditëse, Vendimi i dat.27.10.2017, raporti detal mbi ankesën dt.27.10.2017, formulari i ankesës dt.27.05.2019, procesverbali për kontrollë dhe inspektim datë 20.10.2017, kartela e ujë matësit për periudhën 2006 – 2015, lëshuar me datë 13.10.2017, kartela e matësit dt.2006 – 2015, kartela 2019-lëshuar me datë 01.06.2019, kartela e vjetër lëshuar nga KR për periudhën 31.12.2006 – 01.06.2014, fatura e lëshuar nga sistemi elektronik për vitin 12.10.2017, foto e ujë matësit në vendin e ngjarjes, procesverbali i dt.23.10.2017, me të drejtë ka gjetur se organi i paditur ka analizuar faktet e rastit, dëshmitë dhe argumentet e paraqitura nga palët, andaj, pranë një gjendje të tillë faktike kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore se faturimi i borxhit dhe vendimin nr.147/19 ka qenë kontestues që nga fillimi i kësaj procedure. Ky kolegji nuk e aprovoj, ngase konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa qëndrueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, nga arsyet e lartcekura të theksuara edhe nga gjykata e shkallës së parë, dhe si të tilla nuk kanë ndikim në konstatimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.302/2023 me datë 07.02.2024

**Kryetari i kolegjit,  
Ramiz Kuqi**